



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiçan, me datë: 06.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiçanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 04.04.2023 në ora 23:59 të parashtruar nga: Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Gjenerator", me nr.identifikues 651-22-12442-1-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651-022-110-111 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të "Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Gjenerator", me nr.identifikues 651-22-12442-1-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651-022-110-111 të datës 04.04.2023 në ora 23:59 kundër Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde - të datës 31.03.2023 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. AK - Komuna e Gjiçanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde të datës 31.03.2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K. me datë 04.04.2023 në ora 23:59, kanë parashtruar kërkesat e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Gjenerator" me nr.identifikues 651-22-12442-1-1-1 dhe numër të

brendshëm i prokurimit: GL 651-022-110-111. Autoriteti Kontraktues me datë 06.04.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; CONTANTI GENERATORS SH.P.K. ,Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara në lidhje me pretendimet e juaja :

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendime është se :

Duke pasur parasysh që në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, më saktësisht tek Aneksi nr. 3 ka specifikuar si sekeret afariste.

Ne si AK – Autoritet Kontraktues në mënyrë që të jemi sa më transparent me gjithë OE ju jemi drejtuar OE në fjalë në lidhje me këtë çështje :

“ Ndërsa, Sa I përket Vendimit të OSHP-së, kjo kërkesë buron nga vendimi I OSHP-së :

Ju drejtohem juve, si OE I rekomanduar për dhënie të kontratës të deklaroni se se cilat nga dokumentet e selektuara si sekret afarist dëshironi të klasifikoni në mënyrë që të përcaktoheni tea to më të rëndësishme “

OE në përgjigjen e tij ka konstatuar se :

Kërkesa per sekret afarist eshte hartuar/dorezuar konform formes standarde te paraqitur ne ANEKS 3 te dosjes se tenderit.

Bazuar ne nenin 11.1 dhe nenin 11.3 te LPP-se / paragrafi 3.1 ne kemi kerkuar qe deshmite lidhur me kapacitetin ekonomik&financiar per tenderin ne fjale si ne nenin 8.1&8.2 te FDT-se dhe deshmite lidhur me kapacitetin teknik&profesional konform nenit 9.1&9.2 te FDT-se te mbeten sekret afarist dhe te mos ju ofrohen paleve tjera.

Kete kerkese e bazojme dhe ne nenin 7.3 dhe 7.5 te udhezimit operativ per prokurim publik i cili ka hyre ne fuqi me 20.10.2022.

Sidoqofte OE mund ti shikoje te gjitha dokumentet e dorezuara per kete projekt ne prani te zyrtarit te prokurimit mirepo nuk mund ti barten deshmite ne USB apo hard copy.

Ju jemi mirenjohes per transparencen tuaj.

Ndërsa, me datë 04.04.2023, ju është lejuar juve qasja si Palë e interesuar në gjithë Ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. Vlenë të ceket që Oferta nuk është mare nga ana juaj në formë fizike, mirëpo ju është dhënë mundësia dhe koha e nevojshme për ju si OE në shqyrtimin e Ofertës së OE “ Infinitt Sh.p.k. ” në formë virtuale.

Arsyeja e mos marjes së ofertës në formë fizike është për arsye se, OE po pretendojnë që ofertat e tyre po keqpërdoren nga palët e treta.

Gjithashtu, Sa I përket asaj që pretendoni se OE ka kontrata dhe referenca të falsifikuara sipas Vendimit të OSHP-së ose më saktësisht edhe tek Mendimi I Ekspertit potencohet :

“ Për të gjitha pikat ku pretend OE se ka falsifikuar referenca, JU si pale ankuese mund ti drejtoheni oragneve kompetente “

Andaj, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurencënn nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

Rrjedhimisht, AK – Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde të datës 31.03.2023

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.